



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubijanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH.nr.07/23

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092), në përbërje prej: Agon Ramadani - Kryetar, Vjosa Gradinaj-Mexhuani- Anëtare dhe Vedat Poterqoi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "TETRONIKS LLC"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Digjitalizimi i sallës së Asamblesë Komunale në objektin e Komunës së re", me nr. të prokurimit: 632-22-12867-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna e Gjakovës, me datën 19. 04. 2023, morri këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet**, si e pa-bazuar ankesa e operatorit ekonomik "TETRONIKS LLC"- Prishtinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit më 04.01.2023 për aktivitetin e prokurimit me titull "Digjitalizimi i sallës së Asamblesë Komunale në objektin e Komunës së re", me nr. të prokurimit: 632-22-12867-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna e Gjakovës, kurse kurse Vendimi i cituar si më sipër i AK mbetet në fuqi.

II. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

III. Meqenëse ankesa e OE ankues është refuzuar si e pabazuar, të njëjtit i konfiskohet tarifa që ka paguar me rastin e parashtrimit të ankesës konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e RKS-së

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 15.11.2022, AK - Komuna e Gjakovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Digjitalizimi i sallës së Asamblesë Komunale në objektin e Komunës së re”, me nr. të prokurimit: 632-22-12867-1-2-1”.

Ndërsa me 22.12.2022 AK - Komuna e Gjakovës ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me datë 25.12.2022 Operatori Ekonomik “TETRONIKS LLC”- Prishtinë ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK - Komuna e Gjakovës. Me datë 30.12.2022 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të Operatori Ekonomik “TETRONIKS LLC”- Prishtinë dhe ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të publikuar me datë 22.12.2022 si dhe AK të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit “Digjitalizimi i sallës së Asamblesë Komunale në objektin e Komunës së re”, me nr. të prokurimit: 632-22-12867-1-2-1.

Me datën 04.01.2023 Operatori ekonomik “TETRONIKS LLC”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 07/2023, kundër B58 Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, Lloji i kontratës: furnizim, Vlera e parashikuar e kontratës: 90,648.00 €.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrrojë ankesë në OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu edhe nenit 108/A të ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie në kompetencat e tij në kuptim të nenit 105 të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 20.01.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit i cili është pranuar nga të dy palët, me ç’rast AK nuk pajtohet me mendimin e ekspertit ndërsa OE ankues pajtohet me mendimin e ekspertit.

Eksperti në Raportin e Vlerësimit rekomandon si në vijim:

- ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar,
- të anulohet njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

-Seanca dëgjimore-

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre, ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

-Konstatimet dhe përfundimet e panelit shqyrtues-

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe analizimit të të gjitha provave të aktivitetit të prokurimit, analizimit të tyre, pretendimeve reciproke të palëve, përfshirë raportin e ekspertit shqyrtues, konstaton se pretendimet ankimore të OE ankues i klasifikon si të pa-bazuara andaj në rastin konkret nuk mbështetet në raportin e ekspertizës për faktin se PSH konsideron se nuk janë dhënë detaje dhe sqarime konkrete se lidhur me cilat pika (kontrata, referenca) kemi pasur mungesë dëshmish që vërtetojnë se ekzaminimi i tenderëve nuk është bërë konform LPP-së, andaj

OE ankues operatori ekonomik “Tetroniks” LL.C, pretendon se grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën në kuadër të pikës III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional ku është kërkuar:

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 130.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjashme.

Si dëshmi e kërkuar dokumentare:

Lista e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha furnizimet e realizuara në 3 (tri) vitet e shkuara, duke saktësuar furnizimet e kryera shumë e kontratës, datën e pranuesit ose certifikatën e ekzekutimit të mire të furnizimeve - (referencë ose raport të pranimi të furnizimeve e cila përputhet me listën e dorëzuar), në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe referenca me Operator Ekonomik privat atëherë Operatori Ekonomik duhet të prezanton situacionet e nënshkruara së bashku me transaksionin bankar, që përputhen me të njëjtën kontratë-referencë.

Konkretisht pala ankuese pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka dëshmuar me referenca se ka kryer furnizime të natyrës së ngjashme si dhe nuk ka ofruar si dëshmi referenca që ka kryer furnizime të tilla në vlerën prej jo më pak se 130.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjashme siç është kërkuar në kuadër të pikës III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional.

Lidhur me këtë pikë ankimore OE ankues gjithashtu pretendon se disa referenca të prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë nuk janë të vlefshme, pasi që janë implementuar në periudhën

më të vjetër se tri vitet e shkuara nga data e njoftimit për kontratë. Prandaj OE i rekomanduar për kontratë do të duhej të shpallej si i pa përgjegjshëm.

Lidhur me këtë pretendim ankimor PSH konstaton se dhe duke pasur parasysh faktin që as OE ankues e as eksperti shqyrtues nuk kanë deklaruar se cilat kontrata, referenca apo informacione konkrete e bëjnë OE të rekomanduar për kontratë të papërgjegjshëm por edhe ankesa në tërësi mbështetet në pretendime të përgjithshme ku atakohet OE i rekomanduar në veçanti lidhur me përmbushjen e kërkesës së lartcekur, duke pasur parasysh këtë situatë, paneli shqyrtues ka duke u bazuar në dokumentet që i ka dorëzuar OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij, ka analizuar dhe shqyrtuar të gjitha kontratat dhe referencat e paraqitura veç e veç në listën e kontratave dhe referencat po ashtu që nuk janë paraqitur në listë, dhe është arritur deri tek vendimi se i njëjti e ka ofruar listën e projekteve të realizuara në tri vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë, bazuar në dëshmitë e ofruara ka dëshmuar se e plotëson vlerën e kërkuar të projekteve.

Lista e kontratave e paraqitura nga lideri i konzorciumit, OE i rekomanduar “Afa-ing” përmban në total 13 kontrata, vlera totale e të cilave arrin shumën prej 165 844 € , pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në ofertë nga OE i rekomanduar, PSH ka konstatuar se nga kjo listë e paraqitur, kontrata me nr rendor 4, me titull “Implementimi i sistemit të pritjes në radhë nuk mund të merret për bazë për faktin se nuk plotëson kushtin që “të jetë e përfunduar me së largu 3 vite nga data e publikimit të NJK”, andaj duke qenë se publikimi i NJK është bërë me datë 14.11.2022, kjo nënkupton që kontratat e prezantuara duhet që datën e përfundimit ta kenë pas 14.11.2019 kështu që duke qenë se kontrata e lartpërmendur e ka datën e përfundimit me 19.10.2019, rrjedhimisht nuk e plotëson kriterin e kërkuar e gjithashtu kemi pasur edhe kontrata dhe referenca tjera që po ashtu data e përfundimit ka qenë me e largët e se 3 vitet e fundit, kështu që të njëjtat nuk janë konsideruar dhe nuk janë kalkuluar, përveç kësaj, lidhur me kontratat me nr rendor 11, 12, 13 bazuar në dokumentacionin e ofruar nuk janë evidentuar referenca apo dëshmi të dorëzuara, në këtë rast duke u bazuar në A01 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik kur referencat, certifikatat e pranimit mungojnë nga lista e kontratave të prezantuara ky nen udhëzon që mund të kërkohej informata sqaruese, por edhe sikur këto kontrata të mos pranoheshin vlera totale e tyre është 12 400 €, andaj sikur të gjitha këto kontrata të hiqeshin nga lista do të rezultonte vlera totale prej 134,175 €, që përsëri plotësohet kriteri i kërkuar në DT, andaj përfundimisht PSH konstaton se duke u bazuar nga të gjitha si më sipër, bazuar në ofertën e tij është evidentuar OE i rekomanduar ka ofruar dëshmi – referenca të mjaftueshme që rezultojnë me përmbushje të kriterit të cilin pala ankuese e konteston, andaj pretendimi lidhur me këtë kriter nga PSH klasifikohet i pabazuar.

Ndërsa lidhur me pretendimin e OE ankues *“se grupi i operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar broshurë apo katalog për pajisjet e ofertuara. Sipas tij OE i rekomanduar ka nënshkruar dhe vulosur aneksin 1 të specifikimeve teknike dhe nga ky dokument nuk mund të kuptohet se ky grup i OE e dëshmon se ka ofertuar dhe përmbush kërkesat teknike të kërkuara në aneksin 1, pasi që specifikimet teknike në dokumentin e nënshkruar OE i rekomanduar, janë specifikime të kërkuara nga AK e nuk janë specifikime të ofertuara”*.

Paneli shqyrtues konstaton se duke u bazuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë askund nuk figuron një kriter i tillë i kualifikimit, prandaj ankesa e OE lidhur me këtë pikë poashtu konform raportit të ekspertizës nga PSH klasifikohet si e pabazuar.

Paneli shqyrtues sqaron se sipas nenit 7 paragrafi 6 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës pika (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

Bazuar në nenin 56 të LPP-së “të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:

Së pari, vlerësimi të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji; së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji”.

Prandaj duke i pasur parasysh të gjitha faktet dhe dispozitat ligjore si më lartë Paneli shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar nenin 7, 56, 59 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Agon Ramadani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale, dhoma e shkallës së parë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK-Komuna Gjakovë

1x1 OE “TETRONIKS LLC”-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.